

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“STONE 2023” SH.P.K.**

Sot, më date **20.03.2023**, ne te nënshkruarit:

- - **Ilhan Bilgin** lindur me 29/05/1981, shtetas Turk , lindur ne Iskenderun dhe me residence ne Antalya , mbajtes i passaportes nr.**U26625073** , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.
- **Kujtim Haxhi-Hamza** lindur me 23/09/1963, shtetas Maqedonas, lindur ne Prizren dhe me residence ne Lushnje, mbajtes i passaportes nr.**K1223866**, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar...; në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” kemi vendosur të themelojme një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar “**STONE 2023**” SH.P.K. (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet si Shtojca 1.

**Neni 1**

Emri i Shoqërisë është: “**STONE 2023**” SH.P.K.

**Neni 2**

(1)Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Fier, Lushnje, 200 m nga rotondo Plugut , ndetese me numer pasurie 806 dhe zk 1058/3 .

(2)Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: *shpkstone@gmail.com*  
Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë.

**Neni 3**

-Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë 10 vjet dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare ne Qendren Kombetare te Biznesit.

**Neni 4**

**Objekti**

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm :

b. Bar - Restorant, etj.

-Megjithate shoqëria ka te drejte qe te shtoje dhe te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te asamblese se ortakeve.



## **Neni 5**

### **Kapitali themeltar**

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **100 000** (njqind mije) Lekë

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Z. Ilhan Bilgin** : Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej **50 000** (njqind mije) Leke që përbën **50 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku themelues **Z. Kujtim Haxhi-Hamza** : Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej **50 000** (pesedhete mije) Lekë që përbën **50%** te kapitalit themeltar te shoqërisë.

Kontributi i ortakëve do të jetë në para.

## **Neni 6:**

### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Shtimi ose pakesimi i kapitalit themelor mund te behet vetem pasi Asamblea e ortakëve me shumice e ka dekretuar kete dhe per me teper te gjithë ortakët janë te detyruar qe ta repektojnë dhe te kontribuojnë në para ose në natyrë në baze të vendimit të shumicës së asamblese.

## **Neni 7:**

### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen pëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) shitblerjes;(me të drejtën e parablerjes nga ana e ortakëve).
- c) trashëgimise;
- d) dhurimit;
- e) cdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjerisht të transferueshme ndërmjet ortakëve,përsa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltare janë ligjerisht të transferueshme me rrugë trashgimnie.

## **Neni 8**

### **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakëve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë.Asambleja e Ortakëve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi, marrja e vendimeve ,përfundimi nga e drejta e votës dhe te tjera modalitete per funksionimin e organit vendimarrës percaktohen ne statutin e shoqerise.

#### **Neni 9**

##### **Administrimi**

Administrator i shoqerise emerohet Z. **Ilhan Bilgin** lindur me 29/05/1981, shtetas Turk , lindur ne Iskenderun dhe me residence ne Iskenderun , mbajtes i passaportes nr.**U26625073** , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i zgjedhur per nje periudhe 5 vjecare me te drejte rizgjedhje.

Kompetencat dhe përgjegjesitë e Administratorit jane te percaktuara qarte ne statutin e shoqerise.

#### **Neni 10**

##### **Viti financiar-ekspertët**

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar pregatit raportin me shkrim për nxierien e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që tja paraqesë e ta dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

#### **Neni 11**

##### **Prishja-riorganizimi i shoqërisë**

Modalitetet per prishjen dhe riorganizimin e shoqerise jane te percaktuara ne statutin e shoqerise në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

#### **Neni 12**

Akti i Themelimit eshte hartuar ne 4 kopje origjinale.

### **ORTAKËT E SHOQËRISË**

**Ilhan Bilgin**

**Kujtim Haxhi-Hamza**